



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## ENRI SHTETËROR I REVIZIONIT - Njoftim për medime -

Shkup, 10.06.2021

### Inspektoratet në RMV 10 vite punojnë me 50% kapacitet te reduktuar të kuadrit

*Për organizimin dhe funksionimin e sistemit efikas për inspektim, zbatim të plotë të procesit të inspektimit, për veprim parandalues dhe marrjen e masave për parandalimin dhe eliminimin e parregullsive dhe mangësive, NUK janë marrë masa dhe aktivitete të nevojshme nga institucionet kompetente në RMV.*

Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer *revizion të suksesit* me temë *"Kapacitetet institucionale të inspektorateve në Republikën e Maqedonisë së Veriut"*. Revizioni i suksesit u krye për t'iu përgjigjur pyetjes: *"A ofrojnë kapacitetet institucionale të inspektorateve në Republikën e Maqedonisë së Veriut mbikëqyrje efektive të inspektimit"*.

Revizioni i suksesit është kryer në përputhje me *Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2020*. Periudha e përfshirë me revizionin e suksesit është vitet *2017-2019*, ndërsa fusha të caktuara, çështje dhe ngjarje janë mbuluar dhe më pas deri në datën e njoftimit për revizionin e kryer.

Me revizionin e kryer, revizorët konstatuan se në lidhje me *kornizën strategjike dhe ligjore për punën e inspektorateve*, nuk është përgatitur dhe miratuar *Strategjia për zhvillimin e shërbimeve të inspektimit në RMV*, e cila duhet të jetë dokumenti kryesor strategjik afatgjatë në fushën e inspektimit, me qëllime të përcaktuara, politikat dhe masat për zhvillimin e shërbimeve të inspektimit në RMV.

Revizorët analizuan të dhënat e paraqitura nga Këshilli i Inspektimit për licencat e lëshuara për inspektorë në inspektorate dhe shërbime inspektimi, nga të cilat vërtetuan se ishin lëshuar gjithsej *1.692 licenca për 45 lloje inspektorësh të punësuar në 28 inspektorate dhe shërbime inspektimi*, nga të cilat *aktive janë vetëm 842 licenca për inspektor*. Duke pasur parasysh rëndësinë dhe rolin e inspektimeve, zvogëlimi i numrit të inspektorëve në vend, i cili *në 10 vitet e fundit është zvogëluar me rreth 50%* është situatë që kërkon masa urgjente për të rritur dhe ekipuar numrin e inspektorëve në vend.

Në programën e Qeverisë së RMV-së 2020 - 2024, në lidhje me shërbimet e inspektimit, u konkludua se ekziston ende një **mosbesim i madh tek qytetarët** dhe sektorit të biznesit në efikasitetin dhe paanësinë e inspektimeve shtetërore dhe lokale.

Lidhur me reformën e sistemit dhe rregullat në mbikëqyrjen e inspektimit, është parashikuar **emërim i një Zëvendës Kryeministër përgjegjës për koordinimin e të gjitha shërbimeve të inspektimit**, ulje të konsiderueshme të numrit të inspektorateve, ndërsa është planifikuar të rritet numri i inspektorëve për mjedisin jeteësor dhe inspektor për inspektim të tregut.

E rëndësishme është vendosja e platformës së parashikuar **"E-inspektor"** në të gjitha shërbimet e inspektimit, si dhe detyrimi për të publikuar raporte mujore me të dhëna kur, ku dhe me çfarë rezultati janë kryer inspektimet dhe mbajtja e takimeve të rregullta me organizatat e interesuara të shoqërisë civile për të prezantuar rezultatet dhe problemet me të cilat përballen shërbimet e inspektimit.

Duke pasur parasysh përpjekjet e Qeverisë së RMV-së për reformimin e sistemit dhe rregullave në inspektim, si dhe programin e Qeverisë së RMV-së 2020-2024 ku është planifikuar të prezantohet platforma "E-Inspektor", revizorët identifikuan rrezik të lartë për zbatimin e kësaj reforme, për faktin se në sektorin e IKT-së, departamenti i mbështetjes së IKT-së dhe departamenti për e-inspektim, **nuk ka kuadër**, megjithëse janë paraparë 9 vende pune.

Nga analiza e kryer e të dhënave të Këshillit të Inspektimit, revizorët konkluduan se në inspektoratet shtetërore nga **1.006 pozitat e parashikuara për inspektorë**, të plotësuara janë **602 pozicione** ose **60%**, ndërsa në shërbimet e inspektimit nga **418 pozitat e parashikuara për inspektorë**, janë të plotësuara **210 pozita**, respektivisht **50%**.

Në raportin e revizorëve, gjithashtu theksohet se një numër i madh i shërbimeve të inspektimit punojnë me vështirësi, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të inspektorëve dhe nëse në periudhën e ardhshme nuk realizohen punësime të reja, ekziston rreziku që disa inspektorate të mos jenë në gjendje të kryejnë inspektime, gjegjësisht ti kryejnë kompetencat e deleguara me ligj.

Nga analiza e kryer e bazave të të dhënave në dispozicion të inspektorateve, revizioni konkludoi se ato nuk janë të plota dhe nuk përmbajnë të dhëna për subjektet që i nënshtrohen inspektimit. Kjo situatë është për shkak të mosbashkëpunimit të mjaftueshëm me institucionet e tjera shtetërore që kanë kompetenca në lidhje me regjistrimin e subjekteve që janë subjekt i inspektimit.

Revizorët gjithashtu konkluduan që në vendin tonë nuk është vendosur sistem i integruar informatikë për monitorimin e funksionimit të shërbimeve të inspektimit. Mungesa e një sistemi të tillë informatikë krijon rrezik për subjektivizëm në përzgjedhjen

dhe shpërndarjen e mbikëqyrjeve, dhe me atë vështirësohet monitorimi i suksesit të punës së inspektorëve.

Linku deri tek raporti: Raporti përfundimtar për revizionin e kryer të suksesit „ Kapacitetet institucionale të inspektorateve në Republikën e Maqedonisë së Veriut“.

Press kontakt:

Albiona Mustafa Muhaxhiri +389 72 228 203

albiona.mustafa@dzr.gov.mk

Mijalçe Durgutov +389 70 358 486

mijalce.durgutov@dzr.gov.mk

Martin Duvnjak +389 75 268 517

martin.duvnjak@dzr.gov.mk